

# STATISTIKAT E INOVACIONIT NË NDËRMARRJE

2022 – 2024

Bazuar në Vrojtimin mbi Aktivitetin e Inovacionit në Ndërmarrje, për periudhën referuese 2022–2024, rezulton se 44,3 % e ndërmarrjeve me 10 ose më shumë të punësuar kanë ndërmarrë aktivitete inovacioni. Në këtë kategori përfshihen ndërmarrjet që kanë prezantuar inovacione në produkte ose procese biznesi<sup>1</sup>, si edhe ato që kanë pasur aktivitete inovative të papërfunduara ose të braktisura gjatë periudhës së vrojtuar.

Aktiviteti i inovacionit është më i lartë në sektorin e shërbimeve (seksionet G, H, J, K dhe M të NVE Rev. 2), ku 46,7 % e ndërmarrjeve kanë raportuar aktivitete inovative. Ndërkohë, në sektorin e industrisë (seksionet B, C, D dhe E të NVE Rev. 2), kjo përqindje rezulton 41,6 %. Krahasuar me vërtetimin e mëparshëm për periudhën 2020–2022, niveli i aktivitetit të inovacionit ka shënuar rritje, nga 42,9 % në 44,3 %.

## Sektori i Shërbimeve (Fig.1)

- Aktivitetet e Informacionit dhe Komunikacionit rezultojnë me nivelin më të lartë të inovacionit, ku 67,9 % e ndërmarrjeve janë aktive në inovacion.
- Ndërmarrjet në aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit kanë rezultuar aktive në inovacion me 55,1 %.

## Sektori i Industrisë (Fig.1)

- Ndërmarrjet në aktivitetin e Energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar kanë rezultuar aktive në inovacion me 45,0 %.
- Në Industrinë Përpunuese, 43,3 % e ndërmarrjeve kanë rezultuar aktive në inovacion.

## Sipas madhësisë së ndërmarrjeve

- Aktiviteti i inovacionit rezultoi më i pranishëm në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, me mbi 250 të punësuar, ku 66,4 % e tyre kanë zhvilluar aktivitete inovative.
- Ndërmarrjet e mesme, me 50–249 të punësuar, kanë rezultuar aktive në inovacion me 54,3 %.


<sup>1</sup> Inovacioni i produktit është implementimi i një produkti, malli apo shërbimi të ri ose të përmirësuar dukshëm në karakteristikat dhe përdorimin e tij, ndërsa inovacioni i procesit është implementimi i një metode të re ose të përmirësuar dukshëm të prodhimit apo shpërndarjes, duke përfshirë ndryshime në teknika, pajisje dhe software.

**Gjetjet kryesore mbi aktivitetin e inovacionit krahasuar me periudhën paraardhëse, 2020–2022:**

Rezultatet e vrojtimit tregojnë se rritja e aktiviteteve inovative ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga shitja (shitjet neto) dhe në zgjerimin e punësimit në ndërmarrje.


- Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet aktive në inovacion janë rritur me 4,1 pikë përqindjeje. Në vitin 2024, këto shitje përbënin 62,1% të totalit të shitjeve neto të ndërmarrjeve të vrojtuar.
- Numri i të punësuarve në ndërmarrjet aktive në inovacion është rritur me 4,3 pikë përqindjeje. Në vitin 2024, të punësuarit në këto ndërmarrje përfaqësonin 57,8% të totalit të të punësuarve në ndërmarrjet e vrojtuar.
- 32,1 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion bashkëpunuan me ndërmarrje të tjera, organizata shkencore dhe partnerë të tjerë për realizimin e aktiviteteve inovative, nga 30,0 % që ishte kjo përqindje në periudhën e mëparshme.
- 30,1 % e ndërmarrjeve investuan në blerjen e makinerive, pajisjeve ose mjeteve programuese të bazuara në teknologji të re, të përdorura më parë nga ndërmarrja, nga 27,9 % që ishte kjo përqindje në periudhën e mëparshme.
- 5,1 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion përfituan nga mbështetja financiare publike, nga 4,3 % që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm.
- 1,96 % e ndërmarrjeve që nuk kryen inovacion përfituan mbështetje financiare publike, kundrejt 1,8 % në vrojtimin e mëparshëm.
- 7,1 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion përdorën stimuj ose lehtësira fiskale për kompensimin e tatimeve/taksave lidhur me kërkim-zhvillimin dhe aktivitete të tjera inovative, nga 5,9 % që ishte kjo përqindje në vrojtimin e mëparshëm.
- 18,4 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion zhvilluan aktivitete kërkim-zhvillimi, duke shënuar rritje krahasuar me 13,2 % në vrojtimin e mëparshëm.

**FIG. 1 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE AKTIVE NË INOVACION SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK, 2020-2022 DHE 2022-2024 (%)**




Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje

**FIG. 2 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE DHE PROCESIVE NË BIZNES SIPAS SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË, 2022-2024 (%)**



Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2022-2024

**FIG. 3 NDËRMARRJE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE DHE PROCESIVE NË BIZNES SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJEVE, 2022-2024, (%)**



Burimi: Anketa mbi inovacionin në ndërmarrje, 2022-2024

**TAB. 1 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE AKTIVE DHE JO AKTIVE NË INOVACION SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË DHE MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2018-2024**

|                               | Ndërmarrje aktive në Inovacion |             |             | Ndërmarrje jo aktive në Inovacion |             |             |
|-------------------------------|--------------------------------|-------------|-------------|-----------------------------------|-------------|-------------|
|                               | 2018-2020                      | 2020-2022   | 2022-2024   | 2018-2020                         | 2020-2022   | 2022-2024   |
| <b>Gjithsej</b>               | <b>36,6</b>                    | <b>42,9</b> | <b>44,3</b> | <b>63,4</b>                       | <b>57,1</b> | <b>55,7</b> |
| <b>Aktiviteti ekonomik</b>    |                                |             |             |                                   |             |             |
| Industri                      | 32,1                           | 39,3        | 41,6        | 67,9                              | 60,7        | 58,4        |
| Shërbime                      | 41,0                           | 46,0        | 46,7        | 59,0                              | 54,0        | 53,3        |
| <b>Madhësia e ndërmarrjes</b> |                                |             |             |                                   |             |             |
| 10-49 të punësuar             | 32,1                           | 39,5        | 40,9        | 67,9                              | 60,5        | 59,1        |
| 50-249 të punësuar            | 49,0                           | 51,2        | 54,3        | 51,0                              | 48,8        | 45,7        |
| 250+ të punësuar              | 68,2                           | 66,5        | 66,4        | 31,8                              | 33,5        | 33,6        |

Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje

**TAB. 2 TREGUESIT E SHITJEVE NETO PËR NDËRMARRJET AKTIVE NË INOVACION SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK,(%)**

|                 | 2018-2020   | 2020-2022   | 2022-2024   |
|-----------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Gjithsej</b> | <b>55,9</b> | <b>58,0</b> | <b>62,1</b> |
| Industri        | 52,6        | 56,0        | 56,7        |
| Shërbime        | 57,5        | 59,1        | 63,5        |

Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje

**TAB. 3 TREGUESIT E TË PUNËSUARVE PËR NDËRMARRJET AKTIVE NË INOVACION SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK,(%)**

|                 | 2018-2020   | 2020-2022   | 2022-2024   |
|-----------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Gjithsej</b> | <b>51,9</b> | <b>53,5</b> | <b>57,8</b> |
| Industri        | 46,4        | 47,6        | 52,5        |
| Shërbime        | 59,9        | 61,8        | 63,1        |

Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje

**Shënim për përdoruesit:** Të dhëna të detajuara sipas aktivitetit ekonomik dhe klasave të madhësisë së ndërmarrjeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it: [Inovacioni](#). Treguesit e aktivitetit të inovacionit mund të gjenden gjithashtu në seksionin e tabelave të faqes së internetit, te tema: [Shkencë, Teknologji dhe Inovacion](#)

# Metodologjia

Vrojtimi statistikor mbi aktivitetin e inovacionit zhvillohet çdo dy vite dhe periudha e vëzhgimit e mbuluar është periudha tre-vjeçare (2022-2024). Ky vrotim kryhet në të gjitha vendet evropiane dhe bazohet në përkufizime të harmonizuara ndërkombëtarisht, duke mundësuar krahasime ndërmjet vendeve të rajonit, vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve EFTA. Në Shqipëri, të dhënat për inovacionin në ndërmarrje mblidhen dhe prodhohen në përputhje me udhëzimet e [Manualit të Oslo-s](#), standardet metodologjike të Eurostat dhe kërkesat e Rregullores Evropiane për Statistikat e Biznesit (EBS). Për çdo raund të vrotimit, Eurostat harton një pyetësor standard të harmonizuar (Harmonised Data Collection – HDC), i cili siguron harmonizimin dhe krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, ndërsa të dhënat e mbledhura përpunohen, validohen dhe transmetohen sipas standardeve dhe formateve të përcaktuara nga Eurostat.

Në përputhje me Rregulloren Zbatuese (BE) 2022/1092 mbi statistikën e inovacionit, njësitë statistikore të vrotimit janë ndërmarrjet e sektorit financiar dhe jofinanciar me 10 ose më shumë të punësuar të klasifikuara si mëposhtë:

Madhësisë së ndërmarrjes:

- 10–49 të punësuar
- 50–249 të punësuar
- 250 e më shumë të punësuar

Aktivitetit ekonomik, sipas klasifikimit NVE Rev. 2:

- Industri: industria nxjerrëse, industria përpunuese, energjia elektrike, furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve.
- Shërbime: tregtia me shumicë (përveç automjeteve dhe motoçikletave), transporti dhe magazinimi, informacioni dhe komunikacioni, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, aktivitetet arkitektonike dhe inxhinierike, testimi dhe analiza teknike, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, si edhe publiciteti dhe kërkimet e tregut.

Për matjen e aktiviteteve të Inovacionit në ndërmarrje, INSTAT ka intervistuar 2,138 ndërmarrje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

## Përkufizime

- **Një inovacion:** Është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm ose është sjellë në përdorim nga njësia.
- **Ndërmarrje aktive në inovacion:** Një ndërmarrje e angazhuar gjatë periudhës së vëzhgimit 2018-2020 në një ose më shumë aktivitete për të zhvilluar ose prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara ose

procese biznesi për një përdorim të synuar. Gjatë periudhës së vrojtimit mund të jenë aktive në inovacionit si ndërmarrjet novative apo ndërmarrjet jo-novative.

- **Një inovacion produkti:** Është implementimi i një malli apo shërbimi që është i ri ose i përmirësuar dhe që ndryshon ndjeshëm nga mallrat ose shërbimet e mëparshme të ndërmarrjes. Ai përfshin ndryshime të rëndësishme të konstruktit të mallrave. Përfshihen rishitjet e thjeshta të mallrave të reja dhe ndryshimet e një natyre vetëm estetike.
- **Një inovacion procesi biznesi:** Është një proces biznesi i ri ose i përmirësuar për një ose më shumë funksione biznesi që ndryshon ndjeshëm nga proceset e mëparshme të biznesit të ndërmarrjes dhe i cili është zbatuar brenda firmës. Inovacionet e procesit të biznesit përfshijnë metoda të reja ose të përmirësuara për: prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve; shpërndarjes, furnizimit ose logjistikës; komunikimin dhe përpunimin e informacionit; kontabilitetit dhe operacioneve të tjera administrative; praktika biznesi për organizimin e procedurave ose marrëdhënieve me jashtë; organizimit të përgjegjësisë në punë, vendimmarrjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, marketingut për promovim, paketim, çmim, vendosje të produktit ose shërbime pas shitjes.
- Inovacionet duhet të jenë të reja për ndërmarrjen në fjalë, por jo domosdoshmërisht duhet të jenë të reja në treg, d.m.th. ndërmarrja nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht e para që ka prodhuar këto produkte (mallra ose shërbime) ose ka futur këto procese biznesi.
- **Aktiviteti i inovacionit:** Përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion.
- **Autoritetet publike:** Përfshin autoritete lokale ose rajonale, Qeverinë qendrore (ku përfshihen agjencitë e qeverisë qendrore ose ministrive), Programin Horizon 2020 për Kërkimin dhe Inovacionin dhe çdo lloj mbështetje tjetër financiare nga një institucioni i Bashkimit Europian. Mbështetja financiare publike përfshin mbështetjen financiare përmes granteve, kredive të subvencionuara dhe garancive të kredive. Përfshihet financimi i aktiviteteve nën kontratë nga sektori publik.